



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

DREJTORIA E SIGURISË SË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR DEKLASIFIKON PLOTËSISHT PASHK GJACIN, KRYETAR I GJYKATËS SË RRETHIT PËRMET

Gjatë monitorimit të seancës dëgjimore të zhvilluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK), me subjektin e vettingut, Z. Pashk Gjaci, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Përmët, u morën në analizë të tre kriteret e rivlerësimit të përcaktuara në ligjin 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm gjatë gjithë kohës në seancë dhe u mbrojti personalisht.

Drejtoria e sigurisë së informacionit të klasifikuar (DSIK) ka paraqitur pranë KPK-së raportin lidhur me vlerësimin e figurës, në të cilin subjekti është deklasifikuar plotësisht. Sipas raportit të DSIK-së rezulton se për subjektin e rivlerësimit është regjistruar një procedim penal për veprën penale shpërdorim detyre, për të cilin është vendosur pushimi i hetimeve në 2015. Megjithatë, grupi i punës i ngritur pranë DSIK, nga këndvështrimi i përgjithshëm për pastërtinë e figurës, konstatuar papërshtatshmërinë e tij e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmët.

Sipas relatores KPK i ka dhënë 20 ditë kohë subjektit për tu njohur me dosjen si dhe për të disponuar një kopje të saj si dhe i është dhënë mundësia të paraqesë shpjegimet e tij dhe dokumentacionin përkatës për të provuar të kundërtën. Subjekti konfirmoi se ishte njohur me të gjitha materialet e dosjes dhe ka tërhequr një kopje si dhe ka paraqitur shpjegime dhe kërkesë për pranimin e provave shkresore dhe thirrjen e tre dëshmitarëve.

KPK ka rrëzuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e tre dëshmitarëve, pasi e ka çmuar të panevojshme këtë dëshmi. Kjo për arsye sepse ekziston deklarata noteriale e pranuar nga komisioni dhe për këtë KPK e ka njoftuar subjektin. Kjo u konfirmua dhe nga subjekti gjatë seancës. Në vazhdim të seancës subjektit iu dha mundësia të japë shpjegimet e tij, si dhe të dorëzojë një kopje me shkrim.

Lidhur me vlerësimin e pasurisë, në raportin e **ILDKPKI** konstatohet se: deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, ka kryer fshehje të pasurisë, ka kryer deklarim të rremë, nuk është në situatën e konfliktit të interesave.

Nga analiza financiare e KPK-së, pasuritë e deklaruara nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës, nuk përballoheshin me të ardhurat të ligjshme të deklaruara prej tij. Nga hetimi i kryer, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit lidhur me disa pasuri të deklaruara në deklaratën vetting, si më poshtë:

1. Ndërtesë në Than (Mirditë) me sipërfaqe 21 m² privatizuar në 1995 dhe rivlerësuar në vitin 2011, për të cilën KPK ka konstatuar pasaktësi lidhur me vlerën e privatizimit. Në shpjegimet e tij subjekti ka sqaruar se ky ishte një lapsus, dhe se vlera e saktë është ajo që rezulton nga kontrata e privatizimit.
2. Ndërtesë me sipërfaqe 300 m² dhe truall 320 m² në Than Mirditë privatizuar në 1995 dhe rivlerësuar në vitin 2011. KPK ka konstatuar mospërputhje të deklaratimit të subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Mirditë. Pasi i është kaluar barra e provës subjekti ka shpjeguar se Than është komuna në të cilën ndodhet fshati Thith, dhe se pasuria është blerë pjesërisht me letra me vlerë si dhe, me kursimet e tij nga puna si gjyqtar.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

3. Tokë arë me sipërfaqe 2406 m² në bashkëpronësi me familjen në lagjen nr. 5 në Laç, për të cilën subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për financimin e 50% të pasurisë.
4. Shtëpi banimi tre kate në lagjen nr. 2 në Laç, me sipërfaqe ndërtimi 191 m² dhe truall 500 m² e regjistruar në ZVRPP Kurbin në 2011, 100% në emër të subjektit të rivlerësimit. Lidhur me burimin për ndërtimin e shtëpisë është deklaruar me kontribut të përbashkët të subjektit, të babait dhe vëllait të tij. Nga veprimet e kryera dhe provat shkresore ka rezultuar se veprimet janë kryer nga vetë subjekti, përveç blerjes së tokës e kryer nga babai në bashki. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues mbi të ardhurat e babait dhe të vëllait, lidhur me mundësinë financiare të tyre për të kontribuar në ndërtimin e kësaj banese. Ai gjithashtu nuk ka shpjeguar përse shtëpia është regjistruar në vitin 2011, 100% në pronësi të tij.
5. Tokë arë me sipërfaqe 3800 m² dhe shtëpi në Velipojë, Shkodër;
6. Automjet autokaro blerë në vitin 2008, me burim për blerje dhe zhdoganim nga i vëllai si dhe kursime familjare;
7. Letra me vlerë dhuruar nga nëna dhe të depozituara.
8. Tokë arë dhe truall me sipërfaqe 3100 m² në fshatin Petoq, Than të Mirditës, e trashëguar dhe ende e paregjistruar për gabime kufizimesh. Nga hetimi rezulton se nuk është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës.
9. Automjeti i tipit benz, burimi të ardhurat nga puna si avokat si dhe nga kursimet familjare.
10. Depozitë bankare në Raiffeisen Bank në vlerën 3 milion e 500 mije lekë, burimi i të cilës ka ardhur nga shitja e një apartamenti në Laç.
11. Të ardhurat nga avokatia në vlerën 16 milion lekë duke ju referuar vlerës së qarkullimit vjetor, atëherë që KPK për periudhën 2001 deri 2008, përllogarit vlerën 13 milion e 800 lekë.

Në përfundim subjekti kërkoi konfirmimin e tij në detyrë. Trupi gjykues i përbërë nga kryetari Olsi Komici dhe dy antarët Roland Ilia dhe Valbona Sanxhaktari, në orën 12.20 u tërhoq për vendim, seanca e radhës u caktua në datë 21.03.2019, ora 9.00.

Data, vendi, dhe ora e zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftuan paraprakisht, në faqen zyrtare të KPK-së. Seanca ishte e hapur për të interesuarit, që mund ta ndiqnin atë pas shënimit të gjeneraliteteve në hyrje të sallës. Mediave po ashtu, u ishte krijuar hapësira e nevojshme, për ndjekjen e seancës sipas rregullores së miratuar. Seanca e rivlerësimit për subjektin zgjati për 2 orë e 20 minuta.

SHKARKOHET PASHK GJACI, KRYETAR I GJYKATËS SË RRETHIT PËRMET

Më datë 21.03.19, në orën 9.00, Kryetari i trupit gjykues Olsi Komici çeli seancën e radhës për subjektin e rivlerësimit Z. **Pashk Gjaci** .

Kryesuesi i seancës, pasi verifikoi prezencën e palëve (vëzhguesit ndërkombëtar dhe subjektit) relatoi se trupi gjykues ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e dërguar nga organet ndihmëse, ka zhvilluar gjithashtu një procedurë të thellë administrative bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, ka dëgjuar subjektin e rivlerësimit, dhe për këto arsye ai e ka gjykuar të mbyllur seancën dëgjimore.

Në përfundim të vlerësimit të subjektit trupi gjykues i përberë nga Olsi Komici (Kryesues), Valbona Sanxhaktari (Relatore), Roland Ilia (Anëtarë) vendosi:



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- **Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Z. Pashk Gjaci, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Përmet.**

Zbardhja e vendimit do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit publik, si dhe vëzhguesve ndërkombëtar brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore.